4	Kalibrime/Kontroll periodik (cdo muaj) te pajisjes	copë	48
	Riparim/mirembajtje i Aparatures EKO+printer prodhuesi Esaote MyLAB 40 (2 cope)	copë	2
1	Riparim / tastiere komandimit	copë	2
2	Riparim /printer	copë	2
3	Riparim /zevendesim softëare	copë	2
4	Kalibrime/Kontroll periodik (cdo muaj) te pajisjes	copë	48
	Riparim/mirembajtje i Aparatures EKO+printer MyLAB 50 XV (2 cope)	copë	2
1	Riparim / tastiere komandimit	copë	2
2	Riparim / printer	copë	2
3	Riparim /zevendesim software	copë	2

	4 Kalibrime/Kontroll periodik (cdo muaj) te pajisjes	copë	48
Nr.	Loti 7- Riparim/Mirëmbajtje e Aparaturave Mjekësore të prodhuesit ASSING		
7	Lista e pajisjeve dhe Aparaturave Mjekësore të prodhuesit ASSING	Njesia	Sasia 24 muaj
	Riparim/mirembajtje X-Ray Aparat Radiografie dhe Radioskopie Dixhitale dhe pajisjeve aksesore Helios SFD prodhuesi Assing, kati – 1, (Grafi+Skopi)	Copë	1
1	Riparim /zevendesim software	copë	1
2	Riparim /Generator x-ray	copë	1
3	Riparim/ Dedektori x-ray	copë	1
4	Kalibrime/Kontroll periodik (cdo muaj) te pajisjes	copë	24
5	Riparim/zevendesim Printer	copë	1
6	Riparim / panel komandimi	copë	1
	Riparim/mirembajtje X-Ray Aparat Radiografie Dixhitale dhe pajisjeve aksesore Aster SFD prodhuesi Assing (kati – 1) - Grafi	Copë	1
1	Riparim /zevendesim software	copë	1
2	Riparim /Gjenerator x ray	copë	1
3	Riparim/ Dedektori x-ray	copë	1
4	Kalibrime/Kontroll periodik (cdo muaj) te pajisjes	copë	24
5	Riparim/ Printer	copë	1
6	Riparim / panel komandimi	copë	1
	Riparim/mirembajtje i pajisjes X-Ray Aparat Radiografie Dixhitale dhe pajisjve aksesore SPEEDY PLUS DR prodhuesi Assing (Imazheria 1) - Grafi	Copë	1
1	Riparim /zevendesim software	copë	1
2	Riparim /Gjenerator x ray	copë	1
3	Riparim/ Dedektori x-ray	copë	1
4	Kalibrime/Kontroll periodik (cdo muaj) te pajisjes	copë	24
5	Riparim/ Printer	copë	1
6	Riparim / panel komandimi	copë	1

Nr.	Loti 8- Riparim/Mirëmbajtje e Aparaturave Mjekësore të prodhuesit IBIS		
8	Aparaturave Mjekësore për shërbim për Aparat Radiografie Dixhitale Modeli Simply DR te prodhuesit ibis (Urgjenca)	Njesia	Sasia 24 muaj
1	Zevendesim Dedektori x-ray	copë	1
2	Kalibrime/Kontroll periodik (cdo 2 muaj) te pajisjes	copë	12

Nr.	Loti 9- Riparim/Mirëmbajtje e Aparaturave Mjekësore të ndryshme qe kane patur kontrate shërbimi nder vite		
9	Lista e pajisjeve dhe Aparaturave Mjekësore te ndryshme	Njesia	Sasia 24 muaj
1	Aspirator spitalor/102137	cope	2
2	ASPIRATOR KIRURGJIKAL	cope	4
3	Llampe baktericide	cope	2
4	elektrokardiogram	cope	2
5	Shtreter me komande elektrike	cope	20
6	monitor pacienti AXENT CETUS 12 Multi parameter	cope	2
7	Negatoskop	cope	4
8	ELEKTRO-KARDIOGRAME	cope	2
9	Negatoskop	cope	2
10	Elektrokardiograf 12 kanale	cope	2
11	Defibrilator me monitor	cope	2
12	Llampa baktericide e levizshme	cope	2
13	Shtreter mekanik	cope	20
14	Ultrasound terapi	cope	6
15	Terapi infra te kuqe	cope	6
16	Terapi me lazer	cope	6
17	Terapi me vakum	cope	6
18	Magneto terapi	cope	4
19	Elektro- terapi	cope	6

20	Tens	cope	30
21	Aparat per terheqje lumbare-cervikale	cope	2
22	Aparat per onopharesis	cope	6
23	Aparat per Shorteave (Diathermy)	cope	4
24	Aparat per presoterapi	cope	4
25	Aparat per parafinoterapi	cope	2
26	Piste vrapimi	cope	2
27	Elektrokardiograf 12 kanale	cope	2
28	Piste	cope	2
29	Aspirator spitalor	cope	2
30	ASPIRATOR KIRURGJIKAL	cope	2
31	ELEKTROKARDIOGRAME	cope	2
32	Elektrobisturi monopolare	cope	2
33	monitor pacienti	cope	2
34	Llampe baktericide	cope	2
35	Negatoskop	cope	2
36	Llampe baktericide	cope	2
37	Monitor Pacienti	cope	2
38	Shtrat mekanik	cope	20
39	Negatoskop	cope	4
40	ASPIRATOR KIRURGJIKAL	cope	2
41	ELEKTROKARDIOGRAME	cope	2
42	ASPIRATOR KIRURGJIKAL	cope	2
43	DEFRIBILATOR	cope	2
44	elektrobisturi	cope	2
45	Elektrokardiograf me 12 kanale	cope	2
46	Defribilator me monitor	cope	2
47	Llampe baktericide e levizshme	cope	2
48	Elektrokardiograf 12 kanale	cope	2
49	Pompa infuzioni	cope	2

50	Shiringa elektrike	cope	2
51	monitor pacienti AXENT CETUS 12 Multi parameter	cope	2
52	shiringe elektrike, progeti pg-907	cope	4
53	Shtrat reanimacioni elektrik	cope	8
54	Llampe tavanore me 1 kupole	cope	2
55	Shtrat operacioni kirurgji e pergjths	cope	2
56	Llambe tavanore me 2 kupola	cope	2
57	Elektro-bisturi mono/bipolar	cope	2
58	Aspirator fuqi e larte	cope	4
59	Pastrues ajri HEPA	cope	2
60	Elektrokardiograf 12 kanale	cope	2
61	Defribilator me monitor	cope	2
62	Llambe baktericide e levizshme	cope	2
63	llampe salle aper.anesore	cope	2
64	holter presioni	cope	2
65	holter ritmi	cope	2
66	ekg 12 kanale	cope	2
67	ELEKTROKARDIOGRAME	cope	2
68	mikroskop me llampe halogene	cope	4
69	Aspirator elektrik	cope	2
70	ELEKTROKARDIOGRAME	cope	2
71	monitor pacienti	cope	2
72	Nd Negatoskop	cope	2
73	Negatoskop nr.1	cope	4
74	Negatoskop	cope	4
75	Negatoskop	cope	2
76	Negatoskop	cope	2
77	Negatoskop	cope	6
78	Defribilator me monitor	cope	2
79	Llampe baktericide, fikse	cope	16

80	Pompe infuzioni volumetrike	cope	32
81	Pompe infuzioni me shiringe	cope	32
82	Elektrokardiograf 12 kanale	cope	2
83	Pompa infuzioni	cope	8
84	Shiringa elektrike	cope	6
85	shiringe elektrike, progeti pg-907	cope	40
86	Aspirator spitalor	cope	4
87	ASPIRATOR KIRURGJIKAL	cope	2
88	Elektro-bisturi mono/bipolar	cope	12
89	Aspirator fuqi e larte	cope	4
90	Llampe e levizshme	cope	8
91	Shtrat operacioni kirurgji e pergjithsh	cope	8
92	Shtrat operacioni, neurokirurgji	cope	2
93	Pastrues ajri HEPA	cope	6
94	Aspirator universal	cope	10
95	Defribilator me monitor	cope	2
96	Nd negativoskop	cope	2
97	Negatoskop	cope	2
98	Llampe tavanore me 2 kupola	cope	10
99	llampe op kirurgjikale	cope	2
100	Llampe tavanore me 1 kupole	cope	2
101	Llampe tavanore me 2 kupola	cope	4
102	Shtrat operacioni kirurgjie e pergjithsme	cope	6
103	Elektro-bisturi mono/bipolar	cope	6
104	Llambe baktericide fikse	cope	6
105	Pastrues ajri HEPA	cope	4
106	Aspirator Toraksi	cope	2
107	Aspirator universal	cope	8
108	shtrat reanimacioni	cope	8
109	defribilator	cope	2

110	monitor pacienti AXENT CETUS 12 Multi parameter	cope	2
111	EKG 12 kanale SE 1201	cope	2
112	ASPIRATOR KIRURGJIKAL	cope	2
113	elektrokardiogram	cope	2
114	monitor pacienti AXENT CETUS 12 Multi parameter	cope	2
115	Shtreter mekanik	cope	20
116	Shtreter mekanik	cope	20
117	Shtrat me komand elektrike	cope	30
118	Shtrat reanimacioni elektrik	cope	26
119	Shtrat me levizje hidraulike Gima	cope	12
120	Shtrat terapeutik pozicionus	cope	4

Afatet e ekzekutimit (per te gjitha lotet): 24 muaj duke filluar nga data e nenshkrimit te Marrveshjes kuader. Sherbimet do te kryhen menjehere mbas nenshkrimit te minikontratave pergjate periudhes 24 mujore.

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Shërbim i Mirëmbajtjes së Aparaturave dhe pajisjeve mjekësore në SUT” për një periudhë 24 mujore e ndare ne lote:**

Specifikimet Teknike të Përgjithshme

1. Operatori ekonomik duhet të ketë më shumë se një numër kontakti për raportimin e defekteve dhe çështjeve administrative, për të cilët duhet të bëjë me dije Autoritetin Kontraktor (telefon dhe e-mail).
2. Çdo ndryshim kontakti duhet të raportohet menjëherë me shkrim palëve.
3. Stafii (i të kontraktuarit) duhet të jetë i pajisur me kartë (mjet) identifikimi personal gjatë vizitave në ambientet e Kontraktuesit dhe të shoqërohet nga stafii i Sektorit Menaxhimit të Teknologjisë.
4. Stafii teknik i operatorit ekonomik do të operojë në SUT për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes duhet të jetë i siguar pasi kjo e fundit (SUT) nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të operatorit ekonomik në ambientet e saj.

Mirëmbajtja parandaluese/preventive e pajisjeve mjekësore (per shërbimet full risk)

1. Mirëmbajtja parandaluese apo preventive të pajisjeve mjekësore duhet të kryhet në përputhje me rekomandimet e prodhuesit përkatës për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e tyre dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetërsimi apo përkeqësimi i performancës.
2. Shërbimi për ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore duhet të kryhet nga 2(dy) Inxhinierë/Specialistë të certifikuar dhe të trajnuar për pajisjet mjekësore objekt prokurimi.
3. Operatori Ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë Rekomandimet nga prodhuesi i pajisjes/ve dhe një plan veprimesh të mirëmbajtjes parandaluese që përcakton periodicitetin, procedurat operative dhe protokollet që synon të përdorë, përfshirë kalibrimet.

Mirëmbajtja korrigjuese e Pajisjeve mjekësore (per shërbimet full risk)

1. Ndërhyrjet e mirëmbajtjes korrigjuese konsistojnë në përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionimi, në identifikimin e shkaqeve, eliminimin e tyre dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, për garantimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe sigurisë së saj.
2. Shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes, riparimin dhe zëvendësimin e çdo defekti/pjesë të mundshëm/e gjatë periudhës së kontratës, për pajisjen dhe të gjithë aksesoretë të cilat janë të lidhura me të, në mënyrë që ajo të jetë në shërbim të stafit mjekësor si: Tuba X-ray, Dedektorë, Kompjuterë, Hard Drive, DVD-CD, Keyboard, Monitor, RAM, Ups, Bllok ushqimi, printer, infrastrukture rrjeti, fisha, sonda, mansheta, sensorë, elektroda, Ingranazhe, pjesë elektronike, elektrike, mekanike, hidraulike, valvula, pjesë mekanike, rrota, pistonë, motorë etj, dhe ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e pajisjes brenda standarteve të përcaktuara nga prodhuesi.
3. Shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të paraqitet për të kontrolluar e verifikuar defektin brenda 2 orëve nga marrja e njoftimeve (me e-mail dhe/ose telefon të të dhënat e kontaktit të paraqitur) nga Autoriteti Kontraktor për mosfunksionimin normal, probleme të ndryshme apo defekte të pajisjes.
4. Në rastin kur nuk nevojiten pjesë këmbimi, korrigjimi i defektit duhet të realizohet jo më vonë se 24 orë pas marrjes së njoftimit.

-
5. Në rast se konstatohet se për korrigjimin e një defekti nevojiten pjesë këmbimi, OE duhet të furnizojë dhe të vendosë pjesët e këmbimit, të riparojë defektin dhe të vendosë pajisjen në gjendje normale pune brenda 7 ditëve kalendarike.
 6. Pas riparimeve apo ndërhyrjeve të kryera, zëvendësimi pjesësh këmbimi apo aksesorësh, shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të kryejë kalibrimet e nevojshme, verifikimin e parametrave sikurse e rekomandon prodhuesi, për garantimin e funksionimit normal të pajisjes.
 7. Shoqëria e kontraktuar do mundësojë të paktën një herë për secilën pajisje të grupit të pajisjeve lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin nëse kjo kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.
 8. Lëvizja, spostimi, çmontimi dhe rimontimi i pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes korrigjuese është në ngarkim dhe përgjegjësi të të Kontraktuarit.

Furnizimi me pjesë këmbimi dhe aksesorë

1. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale ose nga prodhues të tjerë të certifikuar, dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, duke siguruar konformitet me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen.
2. Të jenë të certifikuara me CE sipas standardeve dhe direktivave të aprovuara në tregun Evropian.
3. Kur është e aplikueshme, pjesët e këmbimit dhe aksesorët duhet të kenë manual instalimi shoqërues sipas rekomandimeve të prodhuesit. Një kopje e këtij manuali i dorëzohet përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor.
4. Pjesët duhet të kenë jo më pak se 1 (një)* vit garanci nga rikthimi në gjendje të plotë funksionale të pajisjes, ku të përfshihen të gjitha defektet e mundshme të tyre.

(Sqarim: Afati i garancisë së pjesëve të këmbimit mund të tejkalojë afatin e kontratës/marrëveshjes së lidhur. I kontraktuari detyrohet të mirëmbajë, sipas kushteve të garancisë, pjesën e këmbimit edhe pas afatit të përfundimit të kësaj kontrate nëse defekti i pjesës ndodh brenda afatit një vjeçar të garancisë së pjesës së këmbimit/ ose arritjen e maksimumit të konsumit të vërtetuar nga prodhuesi.)

Inspektimi i sigurisë së pajisjeve mjekësore

1. Operatori Ekonomik duhet të kryejë të paktën 1(një) një inspektim sigurie sipas standardit ndërkombëtar elektrik IEC 62353 të specifikuar nga Direktiva e Pajisjeve Mjekësore MDD (ose MDR) 98/79 EC (të përditësuar), ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745 dhe azhurnimet përkatëse, sipas aplikueshmërisë dhe Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Evropës, për çdo pajisje mjekësore dhe pjesëve përbërëse të saj gjatë periudhës së kësaj kontrate, nëpërmjet stafit të trajnuar dhe certifikuar, sipas nevojave të AK.
2. Operatori Ekonomik duhet të kryejë inspektim vizual, testime dhe matje me aparatura të kalibruara, në bashkëpunim me stafin e AK bazuar në specifikimet e prodhuesit.
3. Në përfundim të çdo inspektimi sigurie duhet të përpilohet një raport përshkrues dhe firmoset nga specialistët e AK dhe Inxhinieri/Tekniku i kompanisë (OE) që kryen testin.
4. Pas çdo testimi sigurie në pajisje duhet vendosur një shenjë treguese (të standardizuar nga AK) e gjendjes së sigurisë së pajisjes.
5. Përveç rasteve të sipërpërmendura, shërbimi i inspektimit e verifikimit të sigurisë duhet të kryhet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme.
6. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta dhe Kontraktuesi është i detyruar të pranojë këto kërkesa pa kushte.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

(Kriteret e vecanta te kualifikimit do te jene te njejtat per lotet I, II, III, IV, V, si me poshte)

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2021, 2022 dhe 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori.

Shënim: Kur konkurrohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.*

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 20% e vlerës së fondit limit* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen vërtetime* të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, së bashku

me kontratën përkatëse, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.**

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilën ofertohej.

Kur konkurrohet për më shumë se 1 lot, 20% do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

- 2.3.2** Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën **2(dy)* punonjës Inxhinierë/Specialistë** në stafin e vet ku të paktën njeri të jetë i trajnuar për pajisjet mjekësore objekt prokurimi të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, certifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës. Vetëm ky staf do të kryejë ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore.

Për këtë OE duhet të disponojë dokumentet e mëposhtme provuese për Inxhinierët/Specialistët e mësipërm:

- Diploma
- Certifikatat/dëshmitë e trajnimit për pajisjet objekt prokurimi, lëshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalentet e këtyre certifikimeve lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre,;
- Kontratë pune/ shërbimi e vlefshme.
- Listepagesat e deklaruara ne organet tatimore (formularët E-sig 025) ne tre muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit për inxhinieret bazuar në VKM nr 514 date 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare te profesioneve”.

****Shënim:*** Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe parandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime etj).

****Shënim:*** Ky kriter ne fazën e ofertimit te operatoreve ekonomik do te konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës te vetedeklarimit. Ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

- 2.3.3** OE duhet të paraqesë **Autodeklarate që merr përsipër furnizimi/zëvendësimin me pjesë këmbimi dhe aksesore dhe se:**

- Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale ose nga prodhues të tjerë të certifikuar, dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, duke siguruar konformitet me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen.
- Të jenë të certifikuar me CE ose FDA sipas standarteve dhe direktivave të aprovuara në tregun European.

-
- Kur është e aplikueshme, pjesët e këmbimit dhe aksesorët duhet të kenë manual instalimi shoqërues sipas rekomandimeve të prodhuesit. Një kopje e këtij mauali i dorëzohet përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor.
 - Pjesët duhet të kenë jo më pak se 1 (një)* vit garanci ku të përfshihen të gjitha defektet e mundshme të tyre. (*Sgarim: Afati i garancisë së pjesëve të këmbimit mund të tejkalohet afatin e kësaj kontrate. I kontraktuari detyrohet të mirëmbajë, sipas kushteve të garancisë, pjesën e këmbimit edhe pas afatit të përfundimit të kësaj kontrate nëse defekti i pjesës ndodh brenda afatit një vjeçar të garancisë së pjesës së këmbimit.*)

2.3.4 OE duhet të paraqesë Autodeklarate ku deklaron se do të bëjë inspektimin e sigurisë së pajisjeve mjekësore, të paktën 1(një) një inspektim sigurie sipas standardit ndërkombëtar elektrik IEC 62353 të specifikuar nga Direktiva e Pajisjeve Mjekësore MDD (ose MDR) 98/79 EC (të përditësuar), ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Evropës, për çdo pajisje mjekësore dhe pjesëve përbërëse të saj gjatë periudhës së kësaj kontrate, nëpërmjet stafit të trajnuar dhe certifikuar, kur kjo është e zbatueshme. Inspektimi përfshin:

- a. Operatori Ekonomik duhet të kryejë inspektim vizual, testime dhe matje me aparatura të kalibruara.
- b. Operatori Ekonomik duhet të planifikojë kryerjen e këtyre testimeve në bashkëpunim me stafin e Sektorit të Inxhinierisë Klinike bazuar në specifikimet e prodhuesit.
- c. Në përfundim të çdo inspektimi sigurie duhet të përpilohet një raport përshkrues dhe firmoset nga specialistët e Sektorit të Inxhinierisë Klinike dhe Inxhinieri/Tekniku i kompanisë (OE) që kryen testin.
- d. Pas çdo testimi sigurie në pajisje duhet vendosur një shenjë treguese e gjendjes së sigurisë së pajisjes.
- e. Përveç rasteve të sipërpërmendura, shërbimi i inspektimit e verifikimit të sigurisë duhet të kryhet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme.
- f. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta dhe Kontraktuesi është i detyruar të pranojë këto kërkesa pa kushte.

2.3.5 OE duhet të paraqesë Autodeklarate ku garanton se në rast të shpalljes fitues, do të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes, riparimin dhe zëvendësimin e çdo defekti/pjese të mundshme/gjatë periudhës së kontratës, për pajisjen dhe të gjithë aksesorëve të cilat janë të lidhura me pajisjen, në mënyrë që ajo të jetë në shërbim të stafit dhe të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e pajisjes brenda standardeve të përcaktuara nga prodhuesi.

2.3.6 Ofertuesi (Operatori Ekonomik) duhet të lëshojë një Deklaratë me anë të së cilës **merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij** gjatë kohës së punës në ambientet e SUT, dhe kjo e fundit nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të Operatorit Ekonomik në ambientet e saj.

2.3.7 OE duhet të paraqesi autorizim nga prodhuesi ose distributor I autorizuar prej prodhuesit (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet të

cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të kryejë mirëmbajtjen/riparimin ose zëvendësimin e pjesëve të këmbimit të paisjeve objekt i kësaj procedure prokurimi. Autorizimi duhet të jetë original ose kopje e përkthyer dhe noterizuar.

2.3.8 OE duhet të paraqesë **Autodeklarate** me anë të së cilës të përcaktojë më shumë se një person kontakti për raportimin e defekteve dhe çështjeve administrative, për të cilët duhet të bëje me dije Autoritetin Kontraktor (telefon dhe email). Çdo ndryshim kontakti duhet të raportohet menjëherë me shkrim palëve. Stafi (i të Kontraktuarit) duhet të jetë i pajisur me kartë (mjet) identifikimi personal gjatë vizitave në ambientet e Kontraktuesit dhe të shoqërohet nga stafi i Sektorit të Inxhinierisë Klinike.

Shënim për operatorët ekonomikë:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- *Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushës për këto pika do të jete kusht skualifikimi.*
- *Autoriteti Kontraktor mund të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.*
- *Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

3. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

(Kriteret e vecanta te kualifikimit do te jene te njejtat per lotet VI, VII, VIII, si me poshte)

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2021, 2022 dhe 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurren operatori.

Shënim: Kur konkurrohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 20% e vlerës së fondit limit* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurren operatori dhe **që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime*** të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, së bashku me kontratën përkatëse, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.**

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilën ofertohe.

Kur konkurrohet për më shumë se 1 lot, 20% do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën **2(dy)* punonjës Inxhinierë/Specialistë** në stafin e vet ku të paktën njeri të jetë i trajnuar për pajisjet mjekësore objekt prokurimi të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, certifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës. Vetëm ky staf do të kryejë ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore.

Për këtë OE duhet të disponojë dokumentet e mëposhtme provuese për Inxhinierët/Specialistët e mësipërm:

- Diploma
- Certifikatat/dëshmitë e trajnimit për pajisjet objekt prokurimi, lëshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalentet e këtyre certifikimeve lëshuar nga autoritetet të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre,;
- Kontratë pune/ shërbimi e vlefshme.
- Listepagesat e deklaruara ne organet tatimore (formularët E-sig 025) ne tre muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit për inxhinieret bazuar në VKM nr 514 date 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare te profesioneve”.

****Shënim: Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe parandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime etj).***

****Shënim: Ky kriter ne fazën e ofertimit te operatoreve ekonomik do te konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës te vetedeklarimit. Ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.***

2.3.3 OE duhet të paraqesë **Autodeklarate që merr përsipër furnizimi/zëvendësimin me pjesë këmbimi dhe aksesorë sipas kerkesave te Ak ne specifikimet teknike dhe se:**

- Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale ose nga prodhues të tjerë të certifikuar, dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, duke siguruar konformitetet me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen.
- Të jenë të certifikuar me CE ose FDA sipas standarteve dhe direktivave të aprovuara në tregun European.
- Kur është e aplikueshme, pjesët e këmbimit dhe aksesorët duhet të kenë manual instalimi shoqërues sipas rekomandimeve të prodhuesit. Një kopje e këtij mauali i dorëzohet përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor.
- Pjesët duhet të kenë jo më pak se 1 (një)* vit garanci ku të përfshihen të gjitha defektet e mundshme të tyre. (*Sqarim: Afati i garancisë së pjesëve të këmbimit mund të tejkalojë afatin e kësaj kontrate. I kontraktuari detyrohet të mirëmbajë, sipas kushteve të garancisë, pjesën e këmbimit edhe pas afatit të përfundimit të kësaj kontrate nëse defekti i pjesës ndodh brenda afatit një vjekar të garancisë së pjesës së këmbimit.*)

2.3.4 OE duhet të paraqesë Autodeklarate ku garanton se në rast të shpalljes fitues, do të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes/riparimin dhe zëvendësimin e çdo defekti/pjese të parashikuar ne specifikimet teknike gjatë periudhës së kontratës, për pajisjen dhe të gjithë aksesorëve **të cilat janë të lidhura me pajisjen,** në mënyrë që ajo të jetë në

shërbim të stafit dhe të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e pajisjes brenda standardeve të përcaktuara nga prodhuesi.

2.3.5 Ofertuesi (Operatori Ekonomik) duhet të lëshojë një Deklaratë me anë të së cilës **merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij** gjatë kohës së punës në ambientet e SUT, dhe kjo e fundit nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të Operatorit Ekonomik në ambientet e saj.

2.3.6 OE duhet të paraqesi autorizim nga prodhuesi ose distributor I autorizuar prej prodhuesit (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të kryejë mirëmbajtjen/riparimin ose zëvendësimin e pjesëve të këmbimit të paisjeve objekt i kësaj procedure prokurimi. Autorizimi duhet të jetë original ose kopje e përkthyer dhe noterizuar.

2.3.7 OE duhet të paraqesë **Autodeklarate** me anë të së cilës **të përcaktojë më shumë se një person kontakti për raportimin e defekteve** dhe çështjeve administrative, për të cilët duhet të bëje me dije Autoritetin Kontraktor (telefon dhe email). Çdo ndryshim kontakti duhet të raportohet menjëherë me shkrim palëve. Stafi (i të Kontraktuarit) duhet të jetë i pajisur me kartë (mjet) identifikimi personal gjatë vizitave në ambientet e Kontraktuesit dhe të shoqërohet nga stafi i Sektorit të Inxhinierisë Klinike.

Shënim për operatorët ekonomikë:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- *Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushës për këto pika do të jete kusht skualifikimi.*
- *Autoriteti Kontraktor mund të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.*
- *Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

4. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

(Kriteret e vecanta te kualifikimit per lotin IX, do te jene si me poshte)

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2021, 2022 dhe 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori.

Shënim: Kur konkurrohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen vërtetime* të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, së bashku me kontratën përkatëse, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 40% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilën ofertohet.

Kur konkurrohet për më shumë se 1 lot, 40% do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

2.3.2 Të ketë të paktën tre specialistë të lartë në fushën e teknikës Bio-mjekesore (inxhinier biomedical/elektronik/informatic/elektrik ose fusha të ngjashme) për mirëmbajtjen e aparaturave objekt të këtij prokurimi, ku të paktën njeri prej tyre të jetë trajnuar dhe certifikuar për këto kategori pajisjesh për faktin e shumëllojshmërisë të aparaturave të ndryshme që disponon Spitali Universitar I Traumes.

1. Defibrilator, ECG, Elektrobisturi, sisteme infuzioni, incubatore, ngrohës gjaku.
2. Monitorimin e ECG, sistem respirimi, pressionit, temperatures
3. Perpunimit të mostrave, ndarjen, fotometrine, selectimin e elektrodave jonizuese dhe numerimin pjesor.
4. pajisjeve e anestezise të gazrave dhe lengjeve, ventilatorët, legeshtueseve të oksigjenit
5. Sistemet e dializes
6. Sistemet Endoskopike, Sistemet Ultrasound dhe kirurgjise invazive
7. Sistemet e sterilizimit dhe Autoclavat
8. Krevetat e Operacionit dhe Sistemet e ndricimit operator
9. Neurofiziologji
10. Sistemet e radiologjise X-Ray

Për të vërtetuar këtë, OE duhet të paraqesin CV e specialistëve dhe certifikatat /dëshmitë e trajnimit lëshuar nga institucioni i trainimit. Specialistet e lartë të kenë marrëdhënie kontraktuale me ofertuesin. Kjo të vërtetohet duke paraqitur kontratën e lidhur mes tyre.

***Shënim:** Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe parandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime etj).

***Shënim:** Ky kriter në fazën e ofertimit të operatorëve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetedeklarimit. Ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

